



PIKTORËT E DEMOKRACISË



TË GJITHË JEMI TË RËNDËSISHËM

TENOR (10), FJOLLA (11), TUANA (11), EMARA (11), FESTINA (11)



Disa fakte rreth demokracisë

Së pari dëshirojmë t'iu tregojmë që demokracia do të thotë qeverisje nga populli. Ajo për herë të parë është paraqitur në kryeqytetin e Greqisë, në Athinë. Po ashtu ne e dijmë se demokracia ekziston në dy forma. Ato janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Në demokracinë e drejtpërdrejtë, qytetarët marrin vendime përmes referendumeve. Ndërkaq, në atë përfaqësuese qytetarët përmes votave i zgjedhin përfaqësuesit e vet, të cilët janë deputetët.

Kjo e fundit ndahet në dy sisteme: sistemin parlamentar, në të cilin populli zgjedh me anë të votave deputetët, e pastaj deputetët zgjedhin Presidentin; si dhe sistemin presidencial, ku populli vetë zgjedh me anë të votave Presidentin e vendit.

Disa shembuj nga jeta jonë e përditshme për të parë se sa është e rëndësishme që ne si qytetarë të jemi të përgjegjshëm për veprimet që i bëjmë

Në demokraci të gjithë i kemi të drejtat e barabarta, të cilat janë: e drejta e shkollimit, e drejta e lojës, e drejta e familjes, etj. Po të mos i gëzonim këto të drejta, jeta jonë do të ishte shumë më ndryshe. Po të mos ishte e drejta e shprehjes së lirë, shumë qytetarë nuk do të mund t'i shprehnin mendimet e tyre. Kështu nuk do të kishte as llojllojshmëri mendimesh, por as nuk do të ndjeheshin aspak mirë.

Ndërsa, ata qytetarë të cilët jetojnë në një vend demokratik gëzojnë të drejtën e fjalës së lirë dhe ata mund

të shprehen lirshëm gjatë gjithë kohës. Përveç që gëzojmë plot të drejta ne duhet të jemi edhe të përgjegjshëm. Në vijim do t'i përshkruajmë dy shembuj se si duhet të jemi të përgjegjshëm.

Artani dhe Besniku janë shokë. Artani ka shumë qejf të luaj futboll. Edhe Besnikut i pëlqen të luaj futboll, por shokët e tij nuk e lënë atë të luaj së bashku me ta. Të gjithë shokët kanë bërë një gabim shumë të madh, sepse Besniku si të gjithë fëmijët e tjerë ka të drejtën e lojës. Mësimi ynë nga ky shembull: të gjithë duhet të respektojmë të drejtat që i kemi.

Ishin disa fëmijë të cilët po bisedonin për ngjyrat e tyre të preferuara. Dikujt i pëlqente ngjyra e kuqe, e dikujt e zeza. Të gjithë kishin mendime të ndryshme, por gjatë bisedës ata i respektonin mendimet e të tjerëve dhe kuptoheshin me njëri-tjetrin.


Lulet e një kopshti janë shumëngjyrëshe dhe dallojnë nga njëra-tjetra, por të gjitha kanë nevojë për ujë. Ashtu edhe njerëzit janë të ndryshëm nga njëri-tjetri, por të gjithë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.




Grupi „5 Rrezet e Diellit“



Qytetarët aktiv janë ata të cilët kontribuojnë për vendin e tyre. Këtë e bëjnë duke marrë pjesë në organizime të ndryshme në të mirë të komunitetit me qëllim që ta përmirësojnë atë



Në vitin 507 para erës sonë, në Athinë, është shfaqur forma e parë e demokracisë. Liria dhe barazia janë ndër elementet më të rëndësishme, por ne qytetarët jemi ata të cilët e mbajmë demokracinë



Në procesin zgjedhor, populli voton për përfaqësuesit e shtetit, të cilët janë deputetët. Ata marrin vendime që ndikojnë shumë në jetën e secilit prej neve

JEMI PRO TË DREJTAVE TË BARABARTA

ERA (11), HIMARIOT (11), ANDUELA (11), ALINA (11), ERNES (11)



Nga sistemi demokratik kemi shumë përfitime. Njëri prej këtyre përfitimeve është e drejta për t'i votuar përfaqësuesit e komunës, si dhe përfaqësuesit e shtetit të Kosovës

Po e fillojmë këtë shkrim me një fakt që i ka dhënë kuptim jetës sonë. Është fjala për formimin e shtetit tonë, gjë që e cila ka ndodhur me 17 shkurt 2008. Atë ditë, përfaqësuesit tanë shpallën Kosovën shtet demokratik. Pas kësaj ceremonie të paharrueshme, ne qytetarët e Kosovës, u përmbushëm si qenie njerëzore, sepse me këtë akt ne fituam shumë të drejta. Njëra nga të drejtat tona është e drejta për të zgjedhur.

Në klasën tonë, tradicionalisht një herë në muaj e zgjedhim esenë më të mirë të shkruar nga nxënësit e klasës sonë. Zgjedhjen e bëjmë në bazë të kriterëve, e që disa prej tyre janë: të jetë pa gabime drejtshkrimore; të ketë hyrjen, trungun dhe përfundimin; të jetë ese e pashkruar më parë nga ndonjëri prej nxënësve të klasës, etj.

Ne gjithashtu e zgjedhim edhe kandidatin/en më të mirë të klasës për të marrë pjesë në gara të shkollës. Këto zgjedhje ne i bëjmë me vota të fshehta, sepse kështu krijohet mundësia për të shprehur lirshëm dhe pa presion mendimet dhe preferencat tona.

Zgjedhjet ku ne nuk mund të marrim pjesë akoma janë zgjedhjet lokale dhe ato qendrore. Kjo ndodh sepse ne jemi nën moshën 18 vjeçare, dhe si të tillë nuk kemi akoma të drejtë të votojmë për përfaqësuesit.

Një gjë e dijmë sigurt, se në momentin që e arrijmë këtë moshë, ne do të marrim pjesë në procesin zgjedhor. Kjo sepse të votosh është përgjegjësi qytetare. Ne bëjmë apel që një gjë të tillë ta bëjnë të gjithë qytetarët të cilët e arrijnë këtë kriter, sepse vetëm kështu ne e ndihmojmë zhvillimin e shtetit tonë.



Zgjedhja na takon neve



Vota jonë ka rëndësi për rrethin ku jetojmë

FËMIJËT DHE KUVENDI

DIARD (11), DULZA (10), ADISA (11), DËSHIRA (10)



Ne fëmijët e kemi shumë për zemër Kuvendin. Ky institucion siguron mirëqenie për të gjithë fëmijët përmes...

Në jetën e fëmijëve janë disa gjëra, ndikimi i të cilave ka shumë rëndësi. Njëra ndër këto gjëra është edhe puna e Kuvendit të Kosovës. Por, pse vallë ky institucion ka kaq rol të madh në jetën e fëmijëve, mund të pyet dikush nga lexuesit e gazetës sonë?

Ne e dijmë që si fëmijë nuk e gëzojmë akoma të drejtën e votës, pra, ne nuk votojmë për përfaqësuesit e popullit. Mirëpo, ata çdoherë mendojnë për neve! Kjo është dëshmuar sa e sa herë prej ligjeve që Kuvendi i ka miratuar për fëmijë. Në „Shtëpinë“ ku mbledhen 120 deputetë dhe kuvendojnë për çështje të ndryshme, temat më të dashura për ta janë ato që kanë të bëjnë me fëmijët. Kjo vërehet edhe në fytyrat e tyre gjatë miratimit të ligjeve.

Ligje për fëmijë kemi në numër të madh dhe rëndësia e tyre është shumë e madhe. Por, ne mund të themi se ligji më i dashur për ne fëmijët është ligji për familje. Sa herë që në klasën tonë diskutojmë për ligjet

e ndryshme, më i përfoluri nga ta është pikërisht ky ligj. Çdo fëmijë pa dallime kombësie, etnie, gjinie apo çfarëdolloj dallimi tjetër meriton që të ketë një familje dhe një shtëpi.

Në qytetin tonë njohim disa fëmijë të cilët fatkeqsisht janë braktisur nga familjet e tyre, e kjo gjë e dijmë se është shumë e rëndë për ta. Prandaj, sa herë që i takojmë dhe shoqërohemi me ta ne e kuptojmë rëndësinë e familjes. Pa dyshim që edhe ligjet e tjera që kanë të bëjnë me arsimin apo shëndetësinë kanë rëndësi të madhe.

E si mos t'ia dijmë vlerën Kuvendit ne atëherë, kur të gjitha këto të mira i kemi falë tij? Ajo çka ne mund të bëjmë për këtë institucion është t'i zbatojmë me përpikëri detyrat dhe përgjegjësitë që na vijnë nga këto ligje.

Mësuesja jonë gjithmonë thotë: „Çdo e mirë, kthehet me të mirë“. Edhe ne e bëmë një të mirë për ju, iu informuam për Kuvendin. E mënyra më e mirë për të na e shpërblyer është t'i përcjellni këto informata tek shokët e tjerë!



Disa fakte për Kuvendin



Fëmijët demokratikë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Thimi Mitko“
Klasa: V-1
Vendi: Gjiljan